

Subject Line: Kërkimi për Mbikëqyrësin ka përfunduar - Le t'i urojmë mirëseardhjen Dr. Watlington!

Mirëmëngjes,

Sot, Bordi i Arsimit ka njoftuar emërimin e **Tony B. Watlington Sr., Ed.D.** si Mbikëqyrës të ardhshëm të Rajonit Shkollor të Filadelfias. Kjo është një ditë e mrekullueshme për qytetin tonë!

Dr. Watlington është një edukator me vizion i cili ka 27 vjet përvojë dhe që e filloi karrierën e tij si mësues historie në Qarkun Gilford në Karolinën e Veriut, në vitin 1994. Që prej janarit të vitit 2021, ai ka shërbyer si mbikëqyrës i shkollave Rouen-Salsberi, i vetmi Rajon Shkollor Rigjallërues i Karolinës së Veriut. Më parë ai ka shërbyer si Shef i Shkollave në shkollat e Qarkut Gilford, rajoni shkollor i tretë më i madh në Karolinën e Veriut dhe i 47-ti nga 14.000 rajonet shkollore më të mëdha në Shtetet e Bashkuara. Dr. Watlington është udhëheqës bashkëpunëtor me orientim në rezultate i cili përqendrohet në përmirësimin e sistemeve që çojnë në një arsim të jashtëzakonshëm për çdo nxënës çdo ditë. Ai vjen nga një gjeneratë e parë me diplomë universitare dhe është kampion për mundësi të barabarta si dhe është i përkushtuar për të ndërtuar ekipe bashkëpunëtoresh shkollore dhe të komunitetit të përgjegjshme për krijimin e mundësive për t'i ndryshuar jetën të gjithë fëmijëve duke ngushtuar në të njëjtën kohë hapësirat midis arritjeve dhe mundësive. Ai e mori diplomën e tij universitare si Arsimtar për Histori nga Universiteti i Karolinës së Veriut "A&T State University", diplomën Master në Histori Politike Amerikane nga Universiteti Shtetëror i Ohajos "Ohio State University" dhe një Master në Administrim Shkollash dhe Doktoratë në Udhëheqje Arsimore nga Universiteti i Karolinës së Veriut "University of North Carolina - Chapel Hill", ku ishte një drejtor dashamirës i Karolinës së Veriut. Watlington ka gjithashtu certifikata trajnimi nga Universiteti i Harvardit dhe Jejl dhe është anëtar i Akademisë Urbane Kombëtare të Mbikëqyrësve e cila sponsorizohet nga Shoqata Amerikane e Administratorëve të Shkollave (AASA).

Suksesi akademik i fëmijëve tanë dhe përgatitja e tyre për të shkëlqyer, për të pasur sukses dhe për të qenë udhëheqës në një shoqëri globale mbeten përparësitë më të mëdha të rajonit. Ka qenë kënaqësi për mua që t'ju jap përditësime të herëpashershme për procesin - nga nisja e fazës tonë grumbulluese publike fillestare e deri në korrespondencën tonë më të fundit kur Bordi solli finalistët në Filadelfia. **Faleminderit që i keni dhënë besimin tuaj Bordit ndërsa kemi punuar për të instaluar udhëheqësin më të kualifikuar dhe më me përvojë për të vazhduar me vizionin e Synimeve dhe Masave Mbrojtëse të Rajonit Shkollor për suksesin e nxënësve.**

Për sa i përket hapave të ardhshëm, Dr. Watlington do të fillojë zyrtarisht punën si mbikëqyrës të enjten, më 16 qershor 2022. Ndërsa ai zë vendin e tij dhe fillon të mësohet me rajonin tonë shkollor, Dr. Hite do të jetë instrumental gjatë procesit të marrjes së postit nga mbikëqyrësi - dhe Bordi do të punojë në mënyrë bashkëpunuese me Dr. Watlington dhe palët e interesuara të rajonit shkollor jo vetëm për të mbështetur tranzicionin me lehtësi por edhe për t'u siguruar se po hedhim bazat për suksesin e tij. Atij do t'i nevojitet gjithashtu edhe inkurajimi, mbështetja dhe energjia pozitive e të gjithë qytetit dhe shpresoj që të mbështetem te ju për këtë.

Mbi të gjitha, ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në #PHLSuperSearch. Ju lutem mos ngurroni të vazhdoni të vizitoni **philasd.org/schoolboard/search** për përditësime të mëtejshme për ardhjen e Dr. Watlington në Filadelfia dhe planet tona për t'i uruar atij mirëseardhjen në Qytetin e Dashurisë Vëllazërore dhe Afrimitetit Motëror!

Sinqerisht,

Leticia Egea-Hinton
Zëvendës Presidente

Bordi i Arsimit
Rajoni Shkollor i Filadelfias